REZOLUTË

PËR RAPORTIN VJETOR TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR VITIN 2019

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke nënvizuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në sigurimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë dhe mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke e vënë theksin te rëndësia e plotësimit menjëherë të vendeve të lira në Gjykatën e Lartë, me qëllim funksionalitetin e kësaj Gjykate, si dhe krijimin e kushteve ligjore për zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese nga mbledhja e anëtarëve të Gjykatës së Lartë sipas parashikimeve të nenit 7/ç, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës, sidomos për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe emërimin e gjyqtarëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës;

Duke theksuar rëndësinë e rolit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në drejtimin dhe kujdesjen për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave me fokus hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të politikave për administrimin gjyqësor, monitorimin dhe menaxhimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe miratimin e rregullave të brendshme standarde të gjykatës;

Duke mbajtur në konsideratë nevojat e Këshillit për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit të publikut dhe Kuvendit për gjendjen e sistemit gjyqësor,

Vlerëson:

- Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për plotësimin e tri vendeve të lira në Gjykatën e Lartë me gjyqtarë nga radhët e juristëve të spikatur;

- Procesin e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për ngritjen e gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe rëndësinë e plotësimit sa më shpejt të vendeve të lira në këto gjykata;

- Punën e kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për hartën e re gjyqësore, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit midis Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë për hartimin e propozimit të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave sipas parashikimeve të nenit 13, të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

- Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për hartimin dhe miratimin e një serie aktesh nënligjore normative dhe rregullatore sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, si dhe rëndësinë e përmbylljes së paketës së plotë të këtyre akteve sa më parë;

- Veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit kalimtar dhe rëndësinë e kryerjes së këtij procesi në një kohë sa më të arsyeshme;

- Rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në miratimin e rregullave dhe standardeve të etikës gjyqësore dhe sjelljes së gjyqtarëve, si dhe mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

- Analizat e kryera për shumë aspekte të sistemit gjyqësor, mbarëvajtjen e punës në gjykata dhe masat e marra në këtë drejtim;

- Punën e Këshillit të Lartë Gjyqësor në propozimin dhe administrimin e buxhetit të vet dhe të gjykatave, si dhe nevojat përkatëse;

- Kontributin e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor përmes opinioneve dhe sugjerimeve në procesin e hartimit të legjislacionit dhe/ose përmirësimin e tij.

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2019, të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

• Zhvillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në mbledhje plenare, 57 mbledhje dhe 315 vendime për çështje të ndryshme;

• Krijimin dhe ngritjen e katër komisioneve të përhershme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor: Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Komisioni Disiplinor, Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, si dhe Komisioni i Zhvillimit të Karrierës;

• Punën e zhvilluar nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit në:

- hartimin dhe miratimin e 24 akteve nënligjore;
- zgjedhjen e 36 zëvendëskryetarëve të gjykatave gjatë vitit 2019;
- miratimin e strukturës organizative dhe administratës së Këshillit;
- caktimin e anëtarit përgjegjës të Këshillit për marrëdhëniet me publikun dhe median;
- alokimin e 20 punonjësve shtesë në disa gjykata;
- miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2020–2022 për pushtetin gjyqësor;
- caktimin e anëtarit dhe kryetarit të Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve.

• Punën e zhvilluar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale në:

- hartimin dhe miratimin e 35 akteve nënligjore;
- miratimin e akteve plotësuese të sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve;
- miratimin e programit për vlerësimin etik-profesional për 121 gjyqtarë për vitin 2020;
- miratimin e procedurës së funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës;
- administrimin dhe trajtimin e problematikave lidhur me drejtësinë penale për të mitur dhe mbikëqyrja e trajnimit të tyre nga Shkolla e Magjistraturës;
- miratimin e aktit për krijimin dhe administrimin pranë Këshillit të dosjes personale dhe regjistrit të gjyqtarëve, si dhe krijimi i bazës elektronike të të dhënave për 355 gjyqtarë;
- caktimin e gjyqtarit në pozicionin e këshilltarit të etikës;
- caktimin e 8 gjyqtarëve për mediat në juridiksion apeli, në vijim të miratimit nga Këshilli të Programit të Transparencës për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

• Punën e zhvilluar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në:

- hartimin dhe miratimin e 226 akteve nënligjore;
- miratimin e paketës me 4 akte nënligjore, me qëllim hapjen e thirrjes për procedurën e emërimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur dhe për procedurën e ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve;
- hapjen e thirrjes për 4 vende vakante në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të spikatur.
- krijimin e gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në shkallë të parë dhe apel dhe caktimin e përkohshëm dhe të përhershëm të gjyqtarëve të tyre;
- 76 verifikime të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për emërim në pozicione të ndryshme;
- përcaktimin e kuotave me përkatësisht 25 dhe 40 kandidatëve në profilin gjyqtar, që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, përkatësisht për vitin akademik 2018–2019 dhe 2019–2020;
- miratimin e rregulloreve për kriteret dhe procedurat e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit, transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.
- caktimin e 1209 gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, në përgjigje të 845 kërkesave të ardhura nga kryetarët përkatës të gjykatave.

• Punën e zhvilluar nga Komisioni Disiplinor në:

- krijimin e Komisionit të Përkohshëm kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari;

- shqyrtimin e 181 kërkesave për hetimin e gjyqtarëve nga 729 të tilla;

• krijimin dhe ngritjen e pesë komisioneve të përkohshme pranë Këshillit: Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kritereve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, Komisioni i Përkohshëm kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierës së Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni i Përkohshëm për Hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Komisioni i Përkohshëm për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, të Familjes dhe të Pasurisë së tyre;

• Punën e zhvilluar nga Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në:

- miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve";

- shqyrtimin e 466 subjekteve të rivlerësimit, që kanë paraqitur formularët e rivlerësimit që në fillim të procesit në vitin 2017;

- zhvillimin e 104 shorteve për përzgjedhjen e 520 dosjeve gjyqësore në kuadër të rivlerësimit kalimtar;

- depozitimin e 99 raporteve të hollësishme, të arsyetuara dhe të shoqëruara me 495 dosje gjyqësore pranë organeve të rivlerësimit kalimtar, të grupuara sipas institucioneve;

- përpunimin/relatimin dhe dërgimin pranë organeve të rivlerësimit kalimtar të 110 raporteve të analizimit të aftësive profesionale, që përbën 1/5 e totalit të subjekteve të rivlerësimit;

- dorëzimin nga fillimi i procesit të rivlerësimit, pranë organeve të rivlerësimit kalimtar të 220 raporteve të analizimit të aftësive profesionale ose 50% të të gjitha subjekteve që kanë paraqitur formularin e rivlerësimit pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

• Krijimin dhe bërjen funksional të sistemit "Pro magjistratë", i cili ka krijuar regjistrin digjital të dosjeve profesionale të gjyqtarëve;

• Plotësimin e vakumit të krijuar nga shkarkimet e kryetarëve të gjykatave si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, (36 zëvendëskryetarë nga 37 gjykata);

• Delegimin e gjyqtarëve për 845 çështje në përgjigje të kërkesave të gjykatave kur janë gjendur në pamundësi për të krijuar trupa gjyqësorë, duke caktuar mbi 1209 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të ndryshme;

• Konstituimin e Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duke caktuar në mënyrë të përhershme 5 gjyqtarë dhe në mënyrë të përkohshme 13 gjyqtarë;

• Studimin për krijimin e hartës së re gjyqësore kryer nga grupi i punës, i krijuar dhe që funksionon në bazë të urdhrit nr. 78, datë 18.2.2019, të Kryetarit të Këshillit "Për ngritjen e grupit institucional të punës për vlerësimin dhe riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave";

• Bashkëpunimin e qëndrueshëm me institucionet vendase dhe partnerët ndërkombëtarë.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë Gjyqësor:

1. të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin gjyqësor;

2. t'i kushtojë rëndësi informimit të publikut për qasjen në drejtësi dhe mbarëvajtjes së marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun;

3. të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi;

4. të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin gjyqësor duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020 i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

1. Shpalljen menjëherë të të gjitha vendeve të lira në Gjykatën e Lartë dhe përmbylljen në një kohë sa më të shpejtë të procesit të plotësimit të këtyre vendeve, sipas përcaktimeve të nenit 48, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të

ndryshuar, me qëllim vënien e kësaj Gjykate në funksionalitet të plotë, realizimin e kuorumeve për shqyrtimet gjyqësore, sidomos ato të njësimit të praktikave gjyqësore nga Kolegjet e Bashkuara, si dhe përmbushjen e detyrave të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2. Përfundimin e procedurave për plotësimin e vendeve të lira në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Përmbylljen sa më parë të punës për hartën e re gjyqësore dhe formalizimin e propozimit të përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave.

4. Përmbylljen e paketës së plotë me akte nënligjore normative dhe rregullatore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar dhe ligjeve të tjera, që parashikojnë detyrime për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e Këshillit, veçanërisht aktet që normojnë rregullat e brendshme të funksionimit të Këshillit.

5. Zbatimin e një strategjie efektive për uljen e numrit të çështjeve civile, administrative dhe penale të mbartura, bazuar në analizën e kryer nga Këshilli pasqyruar në raportin vjetor 2019.

6. Bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidaturave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2020–2021.

7. Vijimin me ritme të shpejta të punës në hartimin dhe dorëzimin e raporteve të aftësive profesionale të gjyqtarëve pranë organeve të rivlerësimit kalimtar.

8. Fillimin dhe përfundimin sa më parë të procesit të vlerësimit etik-profesional të gjyqtarëve, në përputhje me skemën e re të vlerësimit.

9. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për magjistratët.

10. Vijimin e dhënies së opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 93, të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 25.6.2020.